



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 21-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 24. 01. 2020, në sallën për mbledhje me fillim në ora 13,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, Kryesues i Komitetit për Komunitete
2. Naim Jahiri
3. Lulzim Rustemi
4. Egzona Fazlija
5. Arben Salihu
6. Ferat Gashi
7. Franjo Goleme
8. Slavisa Trajkovic
9. Zoran Çirković

Të tjerë prezent

1. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës për komunitete
2. Arben Koshi, OSBE
3. Luaras Oseku, OSBE
4. Përfaqësues të UNMIK-ut
5. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**,

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, përshëndeti të pranishmit. Në vazhdim tha se rendin e ditës e keni marrë dhe pyeti a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 20-të e Komitetit për Komunitete.
2. Raporti i punës së Komitetit për komunitete për vitin 2019
3. Të ndryshme

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 20-të të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime, në ekstraktin nga mbledhja e 20-të.

Franjo Goleme, është një gabim teknik te ekstrakti duhet të shenohet 10 përmendore në vend të 10 vorreve.

Meqë vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht.

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 20-të të Komitetit për Komunitete

Shtesë: Ekstrakti.

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Raporti i punës së Komitetit për komunitete për vitin 2019

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, tha se në këtë raport kemi punuar së bashku me Arbenin, dhe punëtorët e sektorit të Kuvendit me Naserin e Beharin dhe jemi munduar që të jetë një raport gjithëpërfshirës.

Në vitin 2019 OSBE-ja na ka vlerësuar me notë shumë të mirë neve si komunitet.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, ju falenderoj juve si ekip për punën që e keni bërë por është dashtë të ceket që drejtorët të jenë present në seancat e komitetit dhe të jenë më të përgaditur pasi që kemi pas raste që drejtorët kanë ardhur të pa përgaditur.

Arben Salihu, është një raport përmbledhës i punës që e kemi bërë. Kjo vërejtje e Lulit është raportuar edhe më heret dhe është në procesverbale dhe nuk e kemi përfshirë në raport.

Naim Jahiri, ju përgëzoj për punën që keni bërë, uroj që ky vit të jetë edhe më i mirë dhe të kemi bashkëpunim edhe më të mirë, është për t'u përshëndetur vlerësimi që na është dhënë nga OSBE-ja neve si komunitet. Ndërsa sa i përket qështjes së drejtorëve kanë qenë bashkëpunues me neve dhe ndonjëherë nuk kanë ardhur në séance për shkak se nuk kanë marrë ftesa.

Zoran Çirkovic, pajtohem edhe me Naimin por edhe me Lulin por në përgjithësi ne si komitet kemi pasur bashkëpunim të mire ku e kemi gjykuar sëbashku rastin e dëmtimit të varrezave po ashtu këtë rast e ka gjykuar edhe Kryetari Komunës.

Lulzim Rustemi, unë e falenderoj Nënkryetarin që ka qenë aktiv po ashtu e falenderoj administratën e komunës për punën që kanë bërë. Ndërsa sa i përket çështjes së drejtorëve e meritojnë një 2 të lodhët.

Naim Jahiri, edhe unë jam për vërejtje por drejtorët janë arsyetuar se nuk kanë marrë pjesë në seanca pasi që nuk kanë pas ftesë.

Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës për komunitete, tha se ju falenderoj edhe juve për bashkëpunimin që kemi pas shpresoj që viti që jemë të ketë më shumë suksese e më pak vërejtje dh eta rrisim performancën tonë.

Arben Koshi, OSBE, ne si OSBE ju falenderojm për bashkëpunimin e në veçanti sektorin e Kuvendit që na ka njoftuar për çdo rast për takimet qoftë komuniteteve apo të Kuvendit po ashtu një falenderim të vaçant kemi për zyrën e përkthimit që kanë qenë shumë bashkëpunues me neve.

Zoran Çirkovic, kam një pyetje pse nuk është prezent askush nga ZLK-ja.

Skender Bikliqi, këtë seancë pasi që nuk ka pasur pike nuk e kemi pare të arsyeshme me qenë dikush nga ZLK-ja por nga séance e ardhshme do të jenë përfaqësuesit e ZLK-së present në çdo seancë.

Në vazhdim tha se edhe njëherë ju falenderoj të gjithëve për bashkëpunimin po ashtu e falenderoj edhe OSBE-n, UNMIK-un dhe shpresojmë që të kemi bashkëpunim edhe më tutje.

Meqë diskutime të tjera nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesi e hodhi në votim dhe me të gjitha votat për, kaloj kjo pikë.

III Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, tha se a ka dikush të diskutoj rreth kësaj pike.

Përfaqësuesi i UNMIK-ut, Stefani, ju falenderoj të gjithëve për bashkëpunimin që kemi pasur dhe deshta të ju njoftoj që me 26 shkurt të vitit 2020 do të ketë një takim me anëtarët e komuniteteve nga regjioni i Prishtinës dhe niveli qëndror ku do të diskutohen disa çështje e ku në këtë takim jeni të ftuar edhe Kryesuesi i Komitetit, Nënkrjetari i Komunës për Komunitete dhe shefi i ZLK-së.

Slavisa Trajkovic, ju përshëndes të gjithëve dhe ju falenderoj për bashkëpunimin që kemi pasur deshta të ju njoftoj që kemi pasur një takim me Kryetarin e Komunës dhe kiemi diskutu rreth dëmtimit të varrezave kun a është premtuar që një rrugë që kalon kah varrezat do të asfaltohet po ashtu nga OSBE-ja na është premtuar vendosja e 4 kamerave te varrezat.

Naim Jahiri, po më vjen mirë që nga takimi që keni pasur kanë dalë rezultate, dhe uroj që raste të tilla të mos përsëriten.

Zoran Çirkovic, ju falenderojmë të gjithëve për angazhimin e deritanishëm. Dhe shpresojmë që ky vit të jet i suksesshëm dhe të mos përsëriten rastet si vitin e kaluar.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14²⁰.

**Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu**

**Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi**